

VENDIM

Nr. 715, datë 5.12.2018

PËR KALIMIN E SPORTELEVE TË INSTITUTIT TË SIGURIMEVE SHOQËRORE NË ADMINISTRIM TË AGJENCISË SË OFRIMIT TË SHËRBIMEVE PUBLIKE TË INTEGRUARA (ADISA)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 50, të ligjit nr. 13/2016, “Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë”, dhe të pikës 2, të nenit 84, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendës-kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në administrim, nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore tek Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA), të sporteleve të shërbimit të agjencive lokale të sigurimeve shoqërore (ALSSH), si më poshtë vijon:

- a) Tiranë;
- b) Kavajë;
- c) Fier;
- ç) Gjirokastrë;
- d) Krujë;
- dh) Shkodër.

2. Rregullat e bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve dhe procedurat e qarkullimit të informacionit e dokumentacionit përcaktohen në marrëveshjen që do të lidhet për këtë qëllim nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA).

3. Agjencia Lokale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë dhe Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) do të ofrojnë njëkohësisht shërbimet në fushën e sigurimeve shoqërore, deri në konsolidimin e mënyrës së ofrimit të shërbimeve nga sportelet e Zyrës Rajonale Tiranë (ADISA).

4. Ngarkohen Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama